

PËRGATITUR NGA: Zj. STOLI LAZE, Auditues Ligjor

DREJTUAR: KOMISIONIT QENDROR ZGJEDHOR

DATA: 10/06/2019

OBJEKTI: Raporti javor i ndërmjetëm i monitorimit

Monitorues/Eksperti financiar: **Zj. STOLI LAZE**
 Zgjedhjet: **ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019**
 Partia/subjekti elektoral: **PARTIA E REFORMAVE DEMOKRATIKE SHQIPTARE**

Rajoni dhe/ose bashkia të monitoruara:

- **QARKU TIRANË**
 - **BASHKIA TIRANË**
- **QARKU ELBASAN**
 - **BASHKIA ELBASAN**
 - **BASHKIA PEQIN**
- **QARKU GJIROKASTËR**
 - **BASHKIA KËLCYRË**

Shkeljet e mundëshme të identifikuar të detyrimeve ligjore të fushatës zgjedhore:

Zyrat elektorale

Nga monitorimi i kryer prej datës **03 Qershor 2019** deri më **09 Qershor 2019** rezulton sa më poshtë:

Zyrat Elektorale / Zyra e lagjeve / zgjedhjeve,

- Kemi dërguar një shkresë zyrtare me postë, drejt Bashkisë Tiranë, Bashkisë Elbasan e Bashkisë Peqin për informacione për zyrat elektorale të partisë së sipër përmendur, në kuadër të detyrimit ligjor të subjekteve zgjedhore të deklarimit të vendodhjes së zyrave elektorale në atë. Jemi në pritje të një përgjigje zyrtare.
- Nuk kemi identifikuar asnjë zyrë elektorale nga monitorimi në terren.
- Nga kontakti i vendosur me kryetarin e subjektit zgjedhor Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, z. Krenar Rryçi, na është komunikuar prej tij që nuk ka zyra elektorale. Ngelet për t'u verifikuar.

Natyra e shkeljeve:

- Nuk është identifikuar asnjë shkelje.

Materiale të fushatës të ndaluara

- Gjatë monitorimit të kryer nuk kemi vërejtur ende, materiale të ndaluara gjatë fushatës.



Miratuar me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019

Eksperti Financiar
 Auditues Ligjor
 Stoli LAZE

